



REPUBLIKA E KOSOVËS
MINISTRIA E ADMINISTRIMIT
TË PUSHTETIT LOKAL



KOSOVO LOCAL
GOVERNMENT
INSTITUTE



AUDITIMI SOCIAL

KOMUNA E SHTIMES
JANAR, 2025



PËRMBAJTJA

RRETH KLGI	7
RRETH MAPL.....	7
HYRJE.....	8
PROFILI I KOMUNËS	9
KONCEPTI I AUDITIMIT SOCIAL	10
PROCESI I AUDITIMIT SOCIAL.....	11
PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	12
HAPAT E PROCESIT TË AUDITIMIT SOCIAL.....	14
METODOLOGJIA.....	14
RRETH PROJEKTEVE	17
GJETJET KRYESORE.....	19
REKOMANDIMET	20
KOMENTET E KOMUNËS	21
LISTA E GRUPIT TË AUDITIMIT SOCIAL	22

RRETH KLGI

Instituti Kosovar për Qeverisje Lokale (KLGI) është organizatë profesionale e dedikuar për të përmirësuar dhe forcuar qeverisjen lokale në Kosovë.

KLGI është themeluar në vitin 2008 bazuar në modele ndërkombëtare të organizatave profesionale. Instituti synon të kontribuojë në vazhdimësinë e procesit të reformave në çështjet e qeverisjes lokale dhe të avancojë sistemin e decentralizuar të qeverisjes, me theks të veçantë në rritjen e llogaridhënies dhe zhvillimin e kapaciteteve në nivel komunal.

Fokusi i KLGI-së është në konsolidimin demokratik dhe mirëfunksionimin e institucioneve të nivelit lokal lidhur me praktikën dhe trendet bashkëkohore. Në këtë perspektivë, KLGI-ja është aktive përmes hulumtimeve, avokimit, rrjeteve, këshillave për politika publike, ngritjen e kapaciteteve dhe forma të tjera të mbështetjes për qeverisjen lokale.

RRETH MAPL

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL) është institucion i administratës shtetërore të Republikës së Kosovës, e themeluar në vitin 2004. Funkcionin e saj, MAPL e ushtron në bazë të Kushtetutës dhe Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale.

Përgjatë këtyre viteve, MAPL ka qenë direkt e përfshirë në procesin e reformës së pushtetit lokal, respektivisht shtrirjen e procesit të decentralizimit në vend, sigurimit të kompetencave të mjaftueshme të pushtetit lokal dhe ushtrimit të tyre në pajtim me Kushtetutën dhe legjislacionin e zbatueshëm. MAPL ndjek një politikë të afirmimit të të drejtave të komunave në rregullimin e çështjeve publike, krijimit të kapaciteteve të mjaftueshme të komunave për të ushtruar veprimtarinë e tyre në pajtim me parimin e ligjshmërisë, subsidiaritetit, transparencës, efikasitetit dhe efektivitetit dhe parimeve të tjera të qeverisjes së mirë.

Misioni i Ministrisë është të rritet autonomia lokale dhe të forcohet aftësia e Komunave, që nëpërmjet pjesëmarrjes aktive të qytetarëve dhe përfaqësimit demokratik, të ofrohen shërbime me kosto efektive për të rritur cilësinë e jetës, sigurinë dhe ekonominë lokale.

HYRJE

Auditimi Social, i zbatuar nga Instituti Kosovar për Qeverisje Lokale (KLGJ) i mbështetur nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL) në Kosovë, ka për qëllim forcimin e partneriteteve ndërmjet pushtetit lokal, shoqërisë civile dhe bizneseve për të krijuar një qytetari aktive gjithëpërfshirëse dhe kohezive.

Ky raport është përgatitur nga Grupi i Auditimit Social, me përfaqësim gjithëpërfshirës, gra, burra, të rinj, të moshuar, nga profesione dhe statuse të ndryshme sociale në komunën e Shtimes.

Projektet e audituara nga grupi:

1. LOT I - Zgjerimi i ndriçimit publik në Shtime dhe në fshatrat: Godanc i Poshtëm, Godanc i Epërm, Lagja e Pajtimit, Belincë, Carralevë, Pjetërshticë dhe Petrovë.
2. LOT II - Zgjerimi i ndriçimit publik në Shtime dhe në fshatrat: Davidoc, Rashincë, Gllavicë, Gjurkoc, Reçak, dhe Mollopole.

Raporti paraqet metodologjinë e zbatuar nga Grupi i Auditimit Social, përfshirë:

- i. Mbledhjen e informacionit; sigurimin e kontratave; analizimin e kontratave sipas parametrave, krahasimet me modelet dhe standardet;
- ii. Monitorimin në terren; takimet me përfitues dhe informacione rrethore (bizneset, qytetarët e rastit si dhe specialistë);
- iii. Hartimin e gjetjeve dhe rekomandimeve; si dhe
- iv. Adresimin/konfirmimin e gjetjeve në takimin me komunën.

Instituti KLGJ, nëpërmjet Auditimit Social ka tri synime:

1. Rritjen e informacionit dhe njohurive për Auditimin Social;
2. Përfshirjen e qytetarëve në proceset publike lokale;
3. Ndërtimin e praktikave për angazhim të vazhdueshëm publik.

PROFILI I KOMUNËS

Shtime

Zona dhe Popullsia

Komuna e Shtimes gjendet në zonën jug të Kosovës. Përfshin një sipërfaqe prej 134 km² dhe përfshin qytetin e Shtimes dhe 23 fshatra. Sipas Regjistrimit të Popullsisë dhe Banesave të Kosovës 2024, popullsia e përgjithshme është **24,308** banorë rezidentë.

Struktura Qeverisëse dhe Pasqyra Politike

Numri i përgjithshëm i votuesve në komunën e Vitisë të regjistruar për zgjedhjet e fundit komunale të mbajtura në tetor 2021 ishte 27,015 duke përfshirë votuesit jashtë Kosovës. Pjesëmarrja në votime ishte 49.7 për qind/13,212 votues (burimi: Komisioni Qendror i Zgjedhjeve).

Përbërja Kuvendit Komunal nga Zgjedhjet Lokale 2021:

1. Legjislativi

Kuvendi Komunal: **21 ulëse**

Rezultatet e zgjedhjeve:

PDK – Partia Demokratike e Kosovës	43,00%	9
LVV – Lëvizja Vetëvendosje	35.66%	8
LDK – Lidhja Demokratike e Kosovës	11.04%	2
AKR– Aleanca Kosova e Re	2.94%	1
LB – Lëvizja për Bashkim	2.27%	1

2. Ekzekutivi

Kryetari i Komunës: **Qemajl Aliu (LVV)**

Drejtoritë e Komunës: **11**



TË ARDHURAT BUXHETORE

Kategoria	Vlera
a. Të hyrat vetanake	858,258€
b. Granti i Përgjithshëm	4,560,657€
c. Granti Specifik për Arsim	3,954,859€
d. Granti Specifik për Shëndetësi	1,203,406€
e. Shërbime Rezidenciale	200,000€
Totali	10,777,180€

BUXHETI NË KATEGORI

Kategoria	Vlera
a. Pagat dhe shtesa	5,998,886€
b. Mallra dhe shërbime	1,502,000€
c. Shpenzime komunale	230,000€
d. Subvencionet dhe transferet	500,00€
f. Investimet kapitale	2,546,294€

Komuna e Shtimes ka:

*Buxhet total: **10,777,180 Euro***

*Staf komunal: **738***

KONCEPTI I AUDITIMIT SOCIAL


Auditimi Social është njëri nga mjetet e informimit, përfshirjes dhe angazhimit qytetarë në proceset komunale. Si dhe njëra nga metodat e kontributit konstruktiv të akterëve (qytetarëve, shoqërisë civile, grupeve të interesit), në veçanti e përfituesve fundorë të investimeve komunale.

Ky proces synon të kontribuojë reciprokisht në dy dimensione: në një të anë, të zgjerojë informacionin, njohuritë dhe përfshirjen e qytetarëve në të gjitha stadet e zhvillimit të investimeve komunale (planifikim, zbatim, monitorim si dhe vlerësim), si dhe në anën tjetër, të rrisë interesin e autoriteteve lokale, për të forcuar pronësinë dhe kontributin direkt të qytetarëve në investimet komunale. Në fokus, për të rritur nivelin e performancës së komunave, në të gjitha stadet e investimeve kapitale nëpërmjet kontributit dhe monitorimit qytetar.

Auditimi Social është në frymën e parimeve të qeverisjes së mirë, duke siguruar se autoritetet lokale, marrin parasysh nevojat, kërkesat dhe interesat publike në proceset e politik-bërjes dhe vendimmarrjes komunale. Si dhe duke siguruar parimet e gjithëpërfshirjes dhe kohezionit social në komuna. Auditimi Social merr kuptim të plotë, atëherë kur publiku ka informacion, është i përfshirë dhe ka rol në proceset e politikave lokale. Përtej mjeteve dhe mekanizmave të zakonshëm, Auditimi Social, ka karakterin e bashkë-dizajnit dhe bashkë-krijimit të politikave lokale. Si hisedar, ai merr edhe rolin e monitoruesit dhe vlerësuesit të zbatimit dhe ndikimit real të investimeve komunale. Kështu, synimi parësorë është të forcojë besimin reciprok në mes qytetarëve dhe autoriteteve lokale.

Instituti KLGI, përgjatë këtij cikli të Auditimit Social, ka vendosur në fokus që pronësia e procesit të bartet tek organizatat dhe aktivistët lokalë, kjo duke siguruar qëndrueshmëri dhe vazhdimësi të proceseve. E, njëkohësisht, që t'i ofrojë nivelit lokal metodologji, mjete dhe kapacitete, për të shtrirë Auditimin Social edhe në projektet tjera komunale.

Për të siguruar qasje sa më efektive në zbatim, Instituti KLGI, është angazhuar në tri (3) dimensione: i. grupet e auditimit të reflektojnë gjithëpërfshirjen e qytetarëve; ii. njohja e vlerave dhe interesave të komunitetit lokal; iii. ndërthurja e dy të parave me proceset, praktikat dhe mekanizmat komunale.




PROCESI I AUDITIMIT SOCIAL

Themelimi i Grupit të Auditimit Social/Takimi i parë

Për të rritur fokusin e Auditimit Social, duke pasur parasysh shtrirjen (zonën) e projektit, grupi është përbërë nga banorët si përfitues direkt, duke siguruar edhe gjithëpërfshirje. Fillimisht, më datë: **28 qershor 2024** u zhvillua takimi koordinues dhe trajnimi për gjashtë (6) organizatat partnere të përfshira në procesin e auditimit social. Nëpërmjet letrës informuese, më datë: **10 korrik 2024**, është njoftuar komuna e Shtimes mbi projektet e përfshira dhe organizatën partnere lokale që do ta zbatojë Auditimin Social. Grupi i Auditimit Social u themelua më datë: **20 korrik 2024**.

Fillimisht janë informuar organizatat lokale dhe kryetarët e Këshillave Lokalë, rreth projektit dhe përfshirjes. Pas angazhimit të tyre, janë identifikuar edhe qytetarë tjerë nga struktura dhe përvoja të ndryshme, duke siguruar diversitet të grupit si: Përfaqësues të bizneseve lokale; përfaqësues të personave me aftësi të kufizuara; përfaqësues nga Kryqi i Kuq; përfaqësues të organizatave rinore; studentë e nxënës; banorë përfitues të këtij projekti. Gjithsej janë përfshirë 15 pjesëmarrës. Për të siguruar komunikim të rregullt është krijuar një grup komunikimi.



Takimi i dytë/Vizita në Terren

Takimi i dytë është mbajtur më **25 tetor 2024**, ku pjesëmarrës nga grupi ishin 15 persona, nga ta 5 gra. Fillimisht u reflektua mbi metodologjinë, stadin e zbatimit të kontratës, analiza të përgjithshme, kriteret, parimet dhe standardet e investimit publik. Po ashtu, u vendosën fokuset e trajtimit nga grupi i Auditimit Social. U ndanë rolet: mbajta e shënimeve, vrojtimit (mjedisi, pjesa inxhinierike, ndjeshmëria gjinore, grupeve të cënueshme, bizneset); fotografimi i gjetjeve.

Takimi i tretë/hartimi i gjetjeve dhe rekomandimeve

Takimi i tretë është mbajtur më **16 nëntor 2024**, ku grupi i Auditimit Social ka analizuar veç e veç secilën gjetje. Fillimisht ka analizuar detajet e kontratës dhe realizimin, pastaj ka vlerësuar anët pozitive dhe mangësitë e planifikimit. Pas kësaj, grupi ka hartuar gjetjet dhe rekomandimet.

Takimi me komunën/adresimi, konfirmimi i gjetjeve dhe ndarja e rekomandimeve

Takimi i katërt me komunën është mbajtur më datë: **17 janar 2025**. Grupi i Auditimit Social në Shtime ka ndarë gjetjet dhe rekomandimet me Nënkryetarin e Komunës dhe ekipin, për projektet e monitoruara. Ku u diskutuan gjetjet dhe u ndanë rekomandimet e projektit të përfshirë në këtë proces të monitorimit. Pas komenteve të komunës, janë reflektuar komentet në raportin final.

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Gjatë periudhës **qershor 2024 - shkurt 2025**, Instituti KLGI me mbështetjen nga MAPL, ka zbatuar procesin e Auditimit Social në gjashtë (6) komuna, pjesë e financimit nga granti i performancës komunale, përfshirë edhe Shtimen.

Në Komunën e Shtimes kanë kaluar në procesin e auditimit social këto projekte:

1. LOT I - Zgjerimi i ndriçimit publik në Shtime dhe në fshatrat: Godanc i Poshtëm, Godanc i Epërm, Lagja e Pajtit, Belincë, Carralevë, Pjetërshticë dhe Petrove.
2. LOT II- Zgjerimi i ndriçimit publik në Shtime dhe në fshatrat: Davidoc, Rashincë, Gllavicë, Gjurkoc, Reçak, dhe Mollopole.

Instituti KLGI, ka përzgjedhur organizatën partnere dhe koordinatorin për komunën e Shtimes, duke e përfshirë në platformën www.klgi-platform.com, ku janë ndarë dhe zbatuar detyrat në këtë sekuencim: koordinatorët, pas vlerësimit të shtrirjes gjeografike të projekteve si dhe strukturës së tyre (rrugë, parqe, shtigje të ecjes, terrene sportive, pajisje për nevoja të komunës dhe punime tjera në infrastrukturë), kanë identifikuar dhe përzgjedhur qytetarët (aktivistë, pjesë e shoqërisë civile, anëtarë të Këshillave Lokalë, profesionistë, përfaqësues apo direkt pjesëtarë të grupeve të nën-përfaqësuar dhe përfitues fundorë); Instituti KLGI dhe koordinatori, kanë përcaktuar dhe përgatitur takimin e parë/trajnimin, ku më pas është rivlerësuar për nevojën e zgjerimit të grupit pas analizimit fillestar të projektit si dhe kanë krijuar grupin e komunikimit elektronik; koordinatori dhe grupi kanë përcaktuar takimet e dyta/vizitat në terren, duke konsultuar përfituesit dhe marrë informacione rrethanore nga bizneset, qytetarët e rastit si dhe specialistë; pas mbledhjes së informacioneve nga terreni, në takimin e tretë, janë hartuar gjetjet dhe nxjerrë rekomandimet; në takimin me komunën janë adresuar/konfirmuar gjetjet dhe janë paraqitur rekomandimet nga procesi i Auditimit Social.

- **LOT I - Zgjerimi i ndriçimit publik në Shtime dhe në fshatrat: Godanc i Poshtëm, Godanc i Epërm, Lagja e Pajtit, Belincë, Carralevë, Pjetërshticë dhe Petrove.**
- **LOT II- Zgjerimi i ndriçimit publik në Shtime dhe në fshatrat: Davidoc, Rashincë, Gllavicë, Gjurkoc, Reçak, dhe Mollopole.**

Në Komunën e Shtimes, projektet e bashkëfinancuara nga Granti i Performancës, kanë pasur një shtrirje të gjerë, përfshirë tri lote dhe 13 lokalitete/fshatra. Mund të theksohet se Komuna e Shtimes, në vitet e fundit ka vendosur orientim të veçantë në zgjerimin e infrastrukturës, me fokus funksionalitetin në tërë territorin. Përgjatë vizitave në terren, janë parë investime në parqe, trotuare, kënde të lojërave për fëmijët, vend pritjet moderne të autobusëve.

Si pjesë e kësaj, investimi në ndriçimin publik, ka ndihmuar në konsolidimin e infrastrukturës, e njëkohësisht rritjen e sigurisë publike. Megjithatë, si rezultat i mungesës së investimeve në rrjetin elektrik nga operatori KEDS, në veçanti shtyllave elektrike, komuna është shtyrë që të vendosë shtylla të veçanta për pasojë ka shtyrë në rritjen kostove të investimeve.

Në disa raste, është evidentuar se Komuna ka hasur një vështirësi në vendosjen e sistemit të ndriçimit publik edhe si rezultat i pengesave nga banorët, duke refuzuar vendosjen e shtyllave në pozicione të caktuara. E, në disa raste, përgjatë planifikimit nuk është arritur të shtohet vlera e projektit, duke i dhënë më shumë mundësi përdorimit të hapësirave publike si terrenet sportive të shkollave. Ku edhe pse përgjatë rrugës është vendosur ndriçimi publik, si i tillë nuk ka pasur shtylla me dy anësore për të ndriçuar edhe oborret shkollore dhe terrenet sportive.

Projektet edhe pse kanë qenë në zhvillim, në disa raste ka pasur vizita nga operatori ekonomik, i cili ka diskutuar me Grupin e Auditimit Social dhe si të tilla disa nga gjetjet e përbashkëta si, vendosja e shenjave të rrezikut (te kapakët elektrikë/furnizuesi) si dhe paralajmërimin të sensori i ndriçimit. Kjo gjetje dhe rekomandim ka ardhur edhe si rezultat i përvojave paraprake, ku sensorët mbulohen dhe si të tillë ndezin ndriçimin duke shtuar shpenzimet.

Në terren, kanë dalë edhe përfaqësues komunalë, të cilët drejtpërdrejt kanë ofruar informacione mbi projektet, si dhe kanë marrë gjetjet nga procesi. Përgjithësisht, ka pasur një diskutim konstruktiv, për adresimin e gjetjeve, por edhe përtej projekteve për të gjetur zgjidhje si të rregullimi i pamjes së tabelës së transitit, apo edhe ndriçimit të terreneve sportive, stacioneve pritëse dhe parqeve të pushimit dhe lojërave për fëmijët.

**Detajet janë të paraqitura në pjesën e gjetjeve, rekomandimeve dhe komenteve të komunës.*

HAPAT E PROCESIT TË AUDITIMIT SOCIAL

Procesi i auditimit social, referohet në metodologjinë e punës përfshirë:

- i. **Mbledhja e informacionit** – sigurimin e kontratave; analizimin e kontratave sipas parametrave, krahasimet me kriteret, parimet dhe standardet;
- ii. **Vizitat/monitorimin në terren** – takimet me përfitues dhe informacione rrethore (bizneset, qytetarët e rastit si dhe specialistë) dhe komentet e anëtarëve të grupit;
- iii. **Puna e grupit të Auditimit Social** – hartimin e gjetjeve dhe rekomandimeve;
- iv. **Takimi në komunë** – adresimin/konfirmimin e gjetjeve në takimin me komunën dhe ndarja e rekomandimeve.

METODOLOGJIA

Përzgjedhja e Projekteve, Komunave dhe Grupit të Auditimit Social

Instituti KLGI, referuar **Aneksit I**, të kontratës (KLGI – MAPL) duke marrë listën e projekteve të bashkëfinancuara nga MAPL dhe Komunitat në kuadrin e Grantit të Performancës Komunale. Ky rregull ka vlejtur në tri (3) komuna (*Viti, Skënderaj dhe Kaçanik*), me nga një projekt në tri (3) komuna (*Drenas, Shtime dhe Ranillug*) dhe me tri (3) e më shumë projekte në (*Skënderaj dhe Shtime*) projekte të bashkëfinancuara nga skema e Grantit të Performancës Komunale. Komunitat ku është kryer Auditimi Social, ofrojnë një pasqyrim të kontekstit të përgjithshëm lokal, duke pasur parasysh, se përfshihen, komuna të mëdha, të vogla, komuna kufitare, me shtrirje të madhe dhe të vogël gjeografike, me përfaqësim të ndryshëm të komuniteteve etnike.

Instituti KLGI, procesin e përzgjedhjes së grupeve të Auditimit Social e ka shtrirë në tri nivele dhe dimensione: i. përzgjedhja e koordinatorëve, aktivist apo të angazhuar në komunitetin lokal; ii. gjithëpërfshirja (diversiteti) brenda grupit të Auditimit Social dhe iii. zgjerimi i grupit të Auditimit Social, sipas kontekstit dhe strukturës së projekteve të monitoruara (parqe, rrugë, terrene sportive, investime në ambient), duke siguruar edhe përfshirjen e përfituesve fundorë.

Fokusi Grupit të Auditimit Social në Shtime

Në projektin “Zgjerimi i ndriçimit publik në Shtime”, Grupi i Auditimit Social ka vendosur tri fokuse: i. Krahasimi i zbatimit të punimeve me kontratën; ii. Ndikimi në sigurinë publike; iii. Efektet në përmirësimin e infrastrukturës në lagje dhe fshatra. Përtej kësaj, janë evidentuar edhe çështjet përtej projektit si rrjeti i dobët elektrik dhe rreziqet, e po ashtu edhe intervenimet në mobilitet dhe parqe në lagje/fshatra.

Indikatorët e performancës të përgatitur nga Grupi i Auditimit Social për projektin e monitoruar janë:

1. A ndoqi zbatimi një plan të qartë veprimi?
2. A ka pasur vonesa në zbatimin e projektit?
3. Nëse po, cilat ishin arsyet e vonesës?
4. Si është realizuar buxheti në relacion me planin?
5. Nëse ka pasur devijime, cilat ishin arsyetimet për çdo devijim buxhetor?
6. Cilat janë rekomandimet për të përmirësuar më tej projektin/?
7. A është krijuar dhe/ose përdorur ndonjë mekanizëm ankesash gjatë zbatimit?
8. A ka ndonjë ankesë të veçantë në lidhje me projektin në fjalë?

Përtej indikatorëve të vlerësimit të zbatimit, monitoruesit kanë nxjerrë të dhëna edhe për ndikimin në mjedis:

1. A ndikon projekti në degradimin e ambientit?
2. A ndikon projekti në rritjen/zvogëlimin e dioksidit të karbonit?

Kërkesat për informacion/dokumente dhe pyetjet e dërguara nga Grupi i Auditimit Social në Komunën e Shtimes:

- Kontratat me detaje janë gjetur të publikuara në ueb faqen e komunës, Zyra për Informim ka ofruar informacione mbi kategorinë ku gjenden të dhënat si dhe linqet e kontratave;
- Kryetari i Komunës, nëpërmes përgjigjes në shkresën e informuese, ka ofruar përkrahje të plotë për procesin auditimit social.

Grupi i Auditimit Social gjatë takimeve në terren me punëkryesit dhe përfaqësuesit komunalë ka shtruar këto çështje dhe ka marrë këto informacione/përgjigje:

- Projektet, a janë pjesë e kërkesave nga qytetarët? Ku edhe sipas raporteve të dëgjimeve buxhetore, por edhe nga diskutimi me zyrtarët komunalë, ndriçimi publik mbetet njëra ndër kërkesat më të shpeshta të qytetarëve;
- Pse është dashur që të vendosen shtylla të ndriçimit në secilën pjesë? Nga raportet e dëgjimeve buxhetore, del se kjo mbetet problematikë e madhe për qytetarët dhe bizneset. Si rezultat i menaxhimit nga KEDS-i, vijon të mbetet sfida e madhe, që paraqet rreziqe, por edhe dëmtime të pajisjeve shtëpiake dhe biznese, nga mos stabiliteti dhe tensioni i ulët;
- Në çështjen e shtruar, se pse në disa raste shtyllat kanë largësi më të madhe se njëra-tjetra? Përgjigjja ka qenë, se disa nga banorët, kanë refuzuar që shtyllat e ndriçimit të vendosen në hapësirat afër shtëpive, me arsyetimin se pengojnë qasjen;
- Në pyetjen për operatorin ekonomik, se a ka pasur ndonjë pengesë gjatë punimeve; Përgjithësisht ata vlerësojnë se punët kanë vijuar sipas dinamikës;
- Në çështjen se pse disa shtylla, mbuluesit e rrjetit nuk kanë izolues (izoluesi prej gome); përgjigjja ka qenë se deri në përfundim do të vendosen të gjithë izoluesit;

- Në çështjen se pse në disa shtylla të ndriçimit ka pasur shenja rreziku e në disa tjera nuk ka pasur? Përgjigja e punë kryesit ka qenë se kjo është varur nga prodhuesi dhe se ata përtej projektit marrin përsipër vendosjen e shenjave të rrezikut.

Çështjet janë shtuar në takimin me komunën:

- Si kanë ndikuar projektet në përmirësimin e cilësisë së infrastrukturës në lagje/fshatra?
- Nga terreni del se komuna është duke bërë intervenime në infrastrukturë dhe parqe, a ka sfida në mirëmbajtje dhe si dhe nga kush kryhet?
- Cilat janë projeksionet për mobilitet në të gjitha zonat (lagje/fshatra) dhe cilat janë kërkesat e dala nga procesi rangimit nga (kontrata sociale)?
- A ka projeksione që ndriçimi publik, të kalohet nga ky aktual në të kombinuar me panele solare?
- Në disa raste edhe pse ka pasur zgjerim të ndriçimit, kjo nuk ka përfshirë hapësirat publike si terrenet sportive, oborret e shkollave dhe institucioneve publike, si do të adresohet kjo çështje?

RRETH PROJEKTEVE

Projekti	“Zgjerimi i ndriçimit publik në Shtime dhe në fshatrat: Godanc i Poshtëm, Godanc i Epërm, Lagja e Pajtimit, Belincë, Carralevë, Pjetërshiticë dhe Petrovë” Numri i prokurimit: 617-24-7140-5-2-1
Çmimi total i punëve në kontratë	206,080.00€
Statusi i kontratës	Në zbatim

Autoriteti Kontraktues: Komuna e Shtimes

Zbatues: Grupi i Operatorëve Ekonomik OE: TALA ENGINEERING SH.P.K; INLINE ENGINEERING SH.P.K; CONSTRUCTION GROUP SH.P.K; Muharrem Hoti B.I; Xhemshir Sejdija B.I.

RIKAPITULIM I PËRGJITHSHËM

NR.	Kategoritë	Shuma
1	Shënimi i trasesë si dhe përcjellja e punimeve gjeodezike gjatë ekzekutimit	3.875.00 €
2	Vendosja e shenjave të përkohshme vertikale dhe atyre për kontroll të trafikut	3.875.00 €
3	Blerja, montimi dhe lidhja e kuadros shpërndarëse elektrike të ndriçimit	7.500.00 €
4	Ndërtimi i bazamentit të betonit	700.00 €
5	Hapja e vrimave dhe vendosja e bazamentit të shtyllave	24.800.00 €
6	Prerja dhe thyerja e betonit, vendosja e bazamentit të shtyllave	270.00 €

*Rikapitulimi i përgjithshëm nga OE gjendet në kontratën e publikuar nga Komuna e Shtimes, por nuk ka përputhje mes shumës totale në kontratë (206,080.00 €) dhe para-masave/para-llogarive (41,020.00 €)

*Rikapitulimi gjendet vetëm në para-masa dhe para-llogari në projektin kryesor.

Projekti	“Zgjerimi i ndriçimit publik në Shtime dhe në fshatrat: Davidoc, Rashincë, Gllavicë, Gjurkoc, Reçak, dhe Mollopole.” Numri i prokurimit: 657-23-6765-5-1-1
Çmimi total i punëve në kontratë	191,602.00 €
Statusi i kontratës	Në zbatim

Autoriteti Kontraktues: Komuna e Shtimes

Zbatues: Grupi i Operatorëve Ekonomik OE: TALA ENGINEERING SH.P.K; INLINE ENGINEERING SH.P.K; CONSTRUCTION GROUP SH.P.K; Muharrem Hoti B.I; Xhemshir Sejdija B.I.

RIKAPITULIM I PËRGJITHSHËM

NR.	Kategoritë	Shuma
1	Shënimi i trasesë si dhe përcjellja e punimeve gjeodezike gjatë ekzekutimit	375.00 €

2	Vendosja e shenjave të përkohshme vertikale dhe atyre për kontroll të trafikut	375.00 €
3	Blerja, montimi dhe lidhja e kuadros shpërndarëse elektrike të ndriçimit	500.00 €
4	Ndërtimi i bazamentit të betonit	350.00 €
5	Hapja e vrimave dhe vendosja e bazamentit të shtyllave	25,810.00 €
6	Furnizimi, transporti dhe montimi i shtyllave metalike të ndriçimit	80,655.00 €
7	Furnizimi, transporti dhe montimi i lidhjes	17,980 €
8	Furnizimi dhe montimi i trupave ndriçuese LED	39,440.00 €
9	Furnizimi dhe montimi i kabllor furnizuese	495.00 €
10	Furnizimi dhe vendosja e kabllor ajrore	18,750.00 €
11	Furnizimi dhe vendosja e gypit PVC	2,900.00 €
12	Furnizimi dhe montimi i shtrënguesve fundor për kabllor ajrore	1,098.00 €
13	Furnizimi, transporti dhe montimi i klemave për lidhjen e dritës	1,098.00 €
14	Furnizimi dhe montimi i rrathëve/unazave për shtylla	1,098.00 €
15	Evidentimi i instalimeve tokësore dhe riparimi i tyre	100.00 €
16	Demolimi i trotuarit ekzistues dhe kthimi në gjendjen e mëparshme	286.00 €
17	Prerja e asfaltit për vendosjen e bazamentit të shtyllës	256.00 €
18	Prerja dhe thyerja e betonit për vendosjen e bazamentit të shtyllës	36.00 €

*Rikapitulimi i përgjithshëm nga OE gjendet në kontratën e publikuar nga Komuna e Shtimes

*Rikapitulimi gjendet vetëm në para-masën dhe paralogaritë në projektin kryesor.

GJETJET KRYESORE

“Zgjerimi i ndriçimit publik në Shtime. Si konstatim i përgjithshëm, vlen të theksohet se: këto projekte, kanë ndikuar pozitivisht në zgjerimin e infrastrukturës në fshatra, lagje e në veçanti në rritjen e sigurisë publike. Ndiriçimi publik, ka kontribuar edhe në projektet tjera që ka vendosur në fokus komuna për përmirësimin e mobilitetit si stacionet e autobusëve si dhe hapësirat publike. Komuna ka pasur një qasje konstruktive, me theksim inkurajimin nga përgjigjja e Kryetarit të Komunës në letrën informuese.




Në fazën ku ishin punimet, vërehej se ende nuk janë vendosur shenjat e rrezikut (tek kutitë e rrjetit elektrik); Si dhe informacion te sensorët e ndezjes (ditë/natë);




Një pjesë e riparimeve në ndërhyrjet në trotuare ishin në fazën finale, megjithatë disa nga kubëzat apo anësoret kërkojnë përmirësim;

Në disa raste varron distanca mes shtyllave të ndriçimit. Kjo vërehet në veçanti



te disa objekte, ku del se banorët kanë refuzuar vendosjen e tyre;



Në Godanc të Poshtëm, po ashtu ende nuk janë fiksuar shtyllat e ndriçimit publik, ato kanë luhatje. Po ashtu, vërehet se ngjyra ka pasuar disa dëmtime;

Përtej Projekteve:



Në projektin në fshatin Godanc i Poshtëm ndriçimi publik, edhe pse kalon në rrugën pranë shkollës, nuk ka pasur shtylla me ndriçim dykahor (për të ndriçuar oborrin dhe terrenin sportiv), por që ka ndikuar pozitivisht tek pritorja (stacioni i autobusëve);



Të shqyrtohet që një pjesë e ndriçimit të hapësirave dhe objekteve, të projektohet në kuadrin e planeve për efijencë të energjisë, si dhe të aplikohet në projekte në këtë fushë.

Nga praktika, konfirmohet se dëmtimet në rrjetin e ndriçimit publik si dhe shpenzimi i orëve (kohës së punës) të planifikohen në pjesën e mirëmbajtës.



Projektet prezantojnë një potencial për zhvillim të infrastrukturës dhe përmirësimin e cilësisë së jetës në lagje/fshatra. Megjithatë, konstatohet se si pasojë e investimeve të pakta dhe problemeve në rrjetin elektrik, ka sfida në zbatim;



Nga praktika, sensorët e ndriçimit publik, shpesh po bien pre e dëmtimeve. Në disa pjesë si rrugën e transitit ata janë të vendosur ulët dhe lehtë të qasshëm.

REKOMANDIMET

Për të përmirësuar zgjerimin e ndriçimit publik në Shtime dhe për të adresuar sfidat e vërejtura, mund të ofrohen disa rekomandime konkrete:

Përmirësimi i vendosjes së shtyllave të ndriçimit dhe eliminimi i pengesave:

- Duhet të shqyrtohet mundësia e riparimit të vendosjes së shtyllave të ndriçimit, veçanërisht në vendet ku ato kanë luhate ose janë dëmtuar. Kjo përfshin përmirësimin e ngjyrës së shtyllave dhe sigurimin që ato janë të qëndrueshme dhe të sigurt.
- Po ashtu, duhet të adresohet problematika e distancës mes shtyllave të ndriçimit, duke siguruar një instalim më të uniformuar dhe funksional.

Përtej Projekteve:

Rishikimi i ndriçimit në zonat e shkollave dhe terreneve sportive:

- Në projektet përfshirëse, si në fshatin Godanc i Poshtëm, është e nevojshme të përfshihet ndriçimi i plotë i oborreve dhe terreneve sportive, për të siguruar që zonat të jenë të sigurt dhe të lehta për përdorim edhe gjatë orëve të natës.

Integrimi i ndriçimit publik me plane të efijencës së energjisë:

- Ndriçimi publik rekomandohet të planifikohet në kuadër të projekteve për efijencën e energjisë, duke përdorur teknologji të reja që mund të kursejnë energji dhe të përmirësojnë performancën e sistemit të ndriçimit. Ky mund të jetë një hap i rëndësishëm për të mbështetur qëndrueshmërinë mjedisore.

Planifikimi i mirëmbajtjes dhe monitorimi i vazhdueshëm:

- Vendosja e shenjës së paralajmërimit se dëmtimet në sensorët e rrjetit të ndriçimit publik paraqet shkelje ligjore. Kjo rritë edhe shpenzimi i orëve të punës;
- Pjesa e mirëmbajtjes duhet vlerësuar në bazë të orëve të punës, si e tillë të planifikohet edhe zëvendësimi, duke mos lënë hapësira pa ndriçim publik funksional.

Vendosja e masave të sigurisë:

- Komuna duhet të sigurohet që të respektohen të gjitha masat e sigurisë, duke përfshirë përdorimin e shenjave të rrezikut përfshirë kutitë e furnizimit, shtyllat eklektike dhe sensorët. Kjo është e rëndësishme për të shmangur aksidentet dhe për të mbrojtur punëtorët dhe qytetarët.

KOMENTET E KOMUNËS

Komentet e përgjithshme

Në takimin me Nënkryetarin e komunës dhe ekipin, u ndanë gjetjet dhe rekomandimet. Përgjithësisht, komuna ka evidentuar këto mangësi. Megjithatë mbetet që këto intervenime të bëhen në ndërhyrjet e ardhme. Ka disa segmente, që nuk lidhen direkt me projektet si ndriçimi i hapësirave dhe objekteve, të projektohet në kuadrin e planeve për efikasitet të energjisë, që kërkon zgjidhje nga një proces i veçantë në këtë sektor.

Komentet Specifike:

- **Rekomandimi:** Vendosija shenjave të rrezikut
 - **Komenti i Komunës:** Komuna konstaton se për këtë rekomandim do të sigurohet përdorimi i shenjave të rrezikut, përfshirë kutitë e furnizimit, shtyllat eklektike dhe sensorët.
- **Rekomandimi:** Përmirësimi i vendosjes së shtyllave të ndriçimit dhe eliminimi i pengesave
 - **Komenti i Komunës:** Punëkryesi është duke kryer punët përfundimtare në fiksimin e shtyllave dhe riparimet e nevojshme.

Përtej Projekteve:

- **Rekomandimi:** Rishikimi i ndriçimit në zonat e shkollave dhe terreneve sportive
 - **Komenti i Komunës:** Do të përfshihet ndriçimi i plotë i oborreve dhe terreneve sportive, për të siguruar që zonat të jenë të sigurta dhe të lehta për përdorim edhe gjatë orëve të natës.
- **Rekomandimi:** Integrimi i ndriçimit publik me plane të efikasitetit të energjisë
 - **Komenti i Komunës:** Do të shqyrtohet planifikimi i efikasitetit të energjisë në kuadrin të projekteve për të përmirësuar performancën e sistemit të ndriçimit.
- **Rekomandimi:** Planifikimi i mirëmbajtjes dhe monitorimi i vazhdueshëm
 - **Komenti i Komunës:** Komuna e konsideroi të vlefshëm rekomandimin duke u zotuar se do të vendoset shenja e paralajmërimit se dëmtimet në sensorët e rrjetit të ndriçimit publik paraqesin shkelje ligjore. Dhe se do të rregullohen edhe orët e punës, për të mos lënë hapësira pa ndriçim publik funksional.

LISTA E GRUPIT TË AUDITIMIT SOCIAL

	Emri dhe Mbiemri	Organizata/Profesioni
1	QËNDRIM HOXHA	Koordinator i grupit
2	TAF FAZLIU	Handikos Shtime
3	LIRIM HALIMI	Kryqi Kuq Shtime
4	YLLKA BAJRAMI	Handikos Shtime
5	FATLUM REXHAJ	OJQ Akademia
6	ARONA QERIQI	Nxënëse
7	DIARTË ZYMERI	Nxënëse
8	ALBION MISINI	Student
9	AGIM HOXHA	Glass Reklama
10	FIDAN SHAQIRI	OJQ Pontis
11	FARUK BAJRAMI	Arsimtar
12	ABDUSELAM RUSHITI	Gardian burgu
13	RINESA BAJRAMI	Studente
14	RESUL GASHI	Student
15	MEDINA MEHMETI	Balkan Sunflowers

